

**STATUT**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"AXE GROUP"sh.p.k.**

**Neni 1: Data e Themelimit,Emri,Themeluesit dhe forma ligjore**

Sot me datë: 19/11/2020, ne të nënshkruarit:

1. **Adriano Giaquinto**, lindur në Lossana, Zvicër dt. 08-10-1978 dhe banues në Montoro (AV),Itali mbajtës i dokumentit tip kartë identiteti me nr personal: AX3273423 .
2. **Eglantina Behari**, lindur më dt. 14.01.1976 dhe banuese në Durrës, mbajtëse e dokumentit tip pasaportë, me nr personal:H65114038U

Themeojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin : **"AXE GROUP"sh.p.k.**

**Neni 2 : Selia**

Selia e Shoqërisëdo te jetëSukth, Durës ZK 3542, nr. pasurie 951

**Neni 3: Objekti i veprimtarisë**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

1. Prodhim dhe tregtim, Import- eksport me shumicë dhe pakicëbrenda dhe jashtë vendit të detergjenteve, artikuj kozmetike, disinfektantë. Import të paisjeve, makinerive dhe linjave të prodhimit, injektimit, paketimit, ndihmëse për këto industri.
2. Import- eksport, tregtim me shumicë dhe pakicë të artikujve parafarmaceutik, maska, doreza, etj.
3. Prodhim dhe tregtim, Import –export, tregtim me shumicë të artikujve të letrës, lënde të para dhe ndihmëse për ketë industri, pajisje, makineri, dhe linja prodhimi,
4. Import –export, tregtim me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit i mallrave të përpunuara industrialo-ushqimore.Pije freskuese,alkoolike dhe joalkoolike,blegtorale(nënprodukte të mishit,të qumëshit,bulmetëra),produktesh ushqimore të konservuara. Import i lëndëve të para dhe materialeve ndihmëse për prodhimin,përpunimin,paketim dhe tregtimin e produkteve industriale ushqimore.
5. Prodhim dhe tregtim,Import –export i ambalazheve për produktet industriale ushqimore, materiale plastike(shishe),druri,kartoni.
6. Import –export, tregtim me shumicë dhe pakicë brënda dhe jashtë vendit,të paisjeve elekroshtëpiake, sanitare,mobilje.
7. Import –export, tregtim me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit së automjeteve dhe tëpjesëve të këmbimit të të gjitha tipave, industriale me shumicë e pakicë.
8. Transport mallrash brenda dhe jashtë vendit për vete dhe të tretë.
9. Të zhvillojë aktivitet në fushën e marketingut, si të shërbimeve marketing; realizim reklamash, fletëpalosje prezantimi, katalogë, produktesh e ecurie të bizneseve e deri tek realizimi i studimeve marketing etj.
10. Të zhvillojë transaksione (e-commerce)
11. Shitje blerje reklamore për nevoja të aktivitetit. Menaxhim ose shfrytëzim i faqeve të internetit (website).
12. Shërbime të pagesave të ndryshme utilitare nga platforma EASYPAY

13. Menaxhim i platformës web dhe mobile si lidhës ndërmjet bizneseve që shesin me shumicë dhe atyre me pakicë.

#### **Neni 4: Kohëzjatja e shoqërisë dhe shtrirja ë aktiviteteve**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj pa afat.

Shoqëriamund të hapë filialet e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

#### **KREU II**

#### **Neni 5: Vlera e kapitalit të rregjistruar**

Kapitali bazë I Shoqërisështë: 15.000 Euro (pesëmbëdhjetë mijë Euro) ndarë në 2 kuota që përkon me 100% të kapitalit.

Adriano Giaquinto, zotërues i 1 kuote që përkon me 51% të kapitalit  
Eglantina Behari, zotëruese e 1 kuote që përkon me 49% të kapitalit  
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ( pasuri të luajteshme/të paluejtshme apo të drejta)

#### **Neni 6: Transferimi i kuotave**

Kuotat e shoqërise apo të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të transferohen nëpermjet:

- a) Shitblerjes
- b) Trashëgimisë
- c) Dhurimit
- d) Cdo mënyre tjeter e parashikuar me ligj.

#### **Neni 7: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës.

Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e

Përgjithëshme me shumicë të kualifikuar të votave.

Shoqëria mund të vendlodë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë

së Përgjithëshme. Ky vendim meret me shumicën e kualifikuar të votave.

#### **Kreu III. Organet vendimarrëse dhe drejtuese** **Asambleja e Përgjithëshme e ortakëve**

#### **Neni 8: Të drejtat dhe detyrimet**

Asambleja e Përgjithëshme e ortakeve, është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë. Konkretisht, Asambleja merr vendime për sa më poshtë:

- a) Përcaktimin e politikave tergjatë të shoqërisë;
- b) Ndryshimet e statutit;

- c) Emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- e) Përtcaktimin e shpërblimeve të administratorëve,likuiduesve dhe tëexpertëve kontabel të autorizuar;
- f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- i) Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
- j) Përfaqësimin e shoqërise në gjykatë dhe në proçedimet e tjera ndaj administratorëve;
- k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- l) Miratimin e mbledhjeve procedurale të asamblesë;

#### **Neni 9: Thirrja e Asamblesë së Përgjithëshme**

Asambleja e Përgjithëshme thirret nga administratorët të paktën dy herë në vit,për të miratuar bilancin vjetor mbylluar si dhe bilancin vjetor parashikues.

Asameja e Përgjithëshme thirret nëse, sipas biancit vjetor apo rraporteve të ndërmjetmeve financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Në këtë rast , Asamblesë së Përgjithëshme i paraqitet një raport nga një expert kontabël i autorizuar i pavarur.

Asambeja e Përgjithëshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive , të cilat kanë vlerë më të lartë se 5% ( pesë përqind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiarë të certificuara. Në ketë rast,Asamblesë sëPërgjithëshme i paraqitet një raport nga një expert kontabël i autorizuar i pavarur.

Asambeja e Përgjithëshme thirret kur shoqëria brenda 2(dy) viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të bjejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë me të lartë se 5% ( pesë përqind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare tëcertificuara. Në këtë rast,Asamblesë sëPërgjithëshme i paraqitet një raport nga një expert kontabël i autorizuar i pavarur.

#### **Neni 10: Mënyra e thirrjes**

Asambleja e Përgjitheshme thirret nëpermjet një njoftimi me shkresë ose njoftim nëpermjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin,datën,orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet te gjithë ortakëve , jo me vonë se 7 ditë përrpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithëshme nuk është thirrur sipas paragrafit të parë të këtij nenii, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marë vendime pamvarësish parregullsisë.

#### **Neni 11: Thirrja e asambesë nga ortakët e pakicës**

Ortakët , të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % (pesë për qind ) të totalit të votave në asamblenë e përgjithëshme të shoqërisë, apo një me të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithëshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës . Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim.Nëse kërkesa rrefuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhë të caktojnëçështjet e rendit të ditës, në përputhje me nenin 10 në këte statut.

Nëse, në kundërshtim me paracaktimin e këtij neni, asambleja e përgjithëshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej aksionerëve të pakicës nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë berë kërkesën, ka të drejtë:

- Të ngrejë padi në gjykatë, për të dekluaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përm bushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- t'i kërkoje shoqërise blerjen e kuotave zotëruar prej tyre.

### **Neni 12: Përfaqësimi në Asamblenë e Përgjithëshme**

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithëshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjeter apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërise nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithëshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm pér një mbledhje të asamblesë së përgjithëshme, e cila përfshin dhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 13: Kuorumet dhe marrja e vendimeve**

Në rastin e marrjes së vendimevetë zakonshme, që kërkojnë një *shumicë të thjeshtë të pakualifikuar* asambleja e përgjithëshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithëshme duhet të vendosë pér çështje, të cilat kërkojnë *shumicë të kualifikuar*, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë me shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse asambleja e përgjithëshme nuk mund të mblidhet pér shkak të mungesës sëkuorumi të përmendor në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbidhet përsëri jo më vonë se 30( tridhjetë) ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambja e Përgjithëshme vendos me *shumicë të kualifikuar* prej *tri* të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, pér:

- ndryshimin e statutit
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të rregjistruar,
- shpërndarjen e fitimeve,
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Pér çështje të tjera të renditura në nenin 8 të këtij statuti, Asambleja e Përgjithëshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Mbledhja e Asamblesë drejtohet nga administratori kur është thirrur prej tij. Nëse Asambleja e Përgjithëshme është thirrur nga pakica, atëherë ajo kryhesot nga një nga ortakët e zgjedhur nga pjesëmarresit në atë mbledhje.

Administratori dhe në rastin kur nuk është ortak i shoqërisë, ka të drejtën e pjesëmarrjes si dhe të mari fjalën në cdo mbledhje të Asamblesë se Përgjithëshme.

#### **Neni 14: Votat e pjesëmarrësve**

Cdo kuotë i jep ortakut të pranishem apo përfaqësuesit të tij të autorizuar të drejtën e një vote.

Asnjë ortak nuk voton në mbledhjen e asamblesë së përgjithëshme nëse nuk ka shlyer të gjitha detyrimet në lidhje me kuotat që ai disponon.

#### **Neni 15: Emërimi I Administratorit**

Administrimi si dhe përfaqësimi i shoqërisë I besohen një apo më shumë administratorëve që mund edhe të mos janë ortakë të shoqërisë.

Afati maksimal i emëritimit të administratorëve ështe 5(pesë) vjet me të drejtë ripërtëritje.

Administrator i parë i shoqërise emërohet zj. Eglantina Behari, me një mandat 5(pesë) vjecar, të cilës i jepen të drejta të përcaktuara në ketë statut. Administratores i jepet e drejta e firmës dhe përfaqësimit të shoqërisë.

Asambleja e Përgjithëshme mund të shkarkojë nëçdo kohë Administratorin nga detyra, me shumicë të zakonshme.

#### **Neni 16: Kompetencat e Administratorit**

Administratori i shoqërise ka të drejtë dhe detyrohet:

Të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithëshme;

- a) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- b) kujdesjen dhe përbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël të shoqërisë;
- c) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisëdhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përrpara asamblesë së përgjithëshme përmiratim;
- d) të krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe eksistencën e shoqërisë;
- e) të kryejnë rregjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë;
- f) të raportojnë përrpara asamblesë së përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecantë per veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret janë të detyruar të thërrasin asamblenë e përgjithëshme, në raset kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- b) shoqëria propozon të shesë apo apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë me të lartë se 5 % ( pese për qind) të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fund vitit finansiar tëçertifikuara.

- c) shoqëria brenda 2(dy) viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të bjejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% ( pesë përqind) të aseteve të shoqërise, që rezulton në pasqyrat e fundit finansiar tëçertificuara.

### Neni:17 Përgjejsitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërise dhe ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërise, ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bëre marrëveshjen, për tu përballuruar në menyrë individuale ose solide sipas rastit.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përzgjithëshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14,15,17,18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, administratoret detyrohen:

- a) të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisënë tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- b) të ushtrojnë kompetencat që ju njihen në lij ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- d) të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;
- e) të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin e nevojshëm.
- f) të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikes 3 të nenit 13 të këtij ligji;

Administratorët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjijken ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtimine rasteve kur, në baze të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratorët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standartet profesionale, janë të detyruar t'i dëmshpërbëlejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe ti kalojnëçdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.

Administratorët kanë barrën e provës per të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve te kërkua. Kur shkelja ështe kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen përpara shoqërise në mënyrë solidare.

Në mënyrë të vecantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar ti dëmshpërbëlejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat ligjore te këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme;

- a) u kthejnë otrakëve kontributet;
- b) u paguajnë ortakëve interesa apo dividente;
- c) u shpërndajnë aktivet shoqërisë;

- d) lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- e) japid kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

#### **Neni 18: Mbledhjet e administratorit**

Administratori kujdest që në libra të posaçëm të mbajë proces verbalet e të gjitha takimeve të kryera nda ai, si edhe të gjitha mbledhjet e Asamblesë se Përgjithëshme.

#### **Kreu IV**

#### **Neni 19: Viti Financiar**

Viti financiar fillon më datë 1 Janar dhe mbylljet më datë 31 Dhjetor. Viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit të shoqërise në organet përkatese sipas legjislacionit në fuqi.

#### **Neni 20: Shpërndarja e fitimit vjetor të shoqërisë**

Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërise në raport me kuotat e zotëruara.

Asambleja e Përgjithëshme mund të vendosë që fitimi I vitit financiar ose një pjesë e tij, t'ju shpërndahet ortakëve ose të përdoret për zmadhimin e kapitalit apo për qëllime të tjera të gjykuara të dobishme për shoqërine dhe të lejuara nga ligji.

#### **KREU V Prishja- Riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 21: Prishja dhe likuidimi**

Ne rast te likuidimit te shoqërisë, Asambleja e Përgjithëshme emëron një likuidator, i cili administron shoqërinë deri në mbylljen e procesit të likuidimit.

Me vendimin e posaçëm të Asamblesë së Përgjithëshme, të marrë me shumicë të kualifikuar, pasi janë shlyer detyrimet ligjore ndaj kreditorëve të shoqërisë, likuidatori shpërndan pjesën e mbetur të shoqërisë ndërmjet ortakëve. Kjo shpërndarje e fundit bëhet me vleren e kapitalit të rregjistruar, që kuotat e secilit ortak përfaqësojnë.

#### **Neni 22: Ftesa për kreditoret**

Likuiduesi duhet të njoftojë kreditorët për të depozituar pretendimet ndaj shoqërisë, shoqëria e publikon këtë njoftim sipas përcaktiveve të dispozitave ligjore.

Pretendimet duhet të depozitohen Brenda 30 (tridhjetë) ditevë nga data e njoftimit të fundit.

#### **Neni 23: Perfundimi i likuidimit**

Pas shpëerndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi njofton organet përkatëse dhe kërkon çrregjistrimin e shoqërisë.

#### Neni 24: Baza ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit Shqiptar.

Për çdo çështje e cila nuk gjen percaktim në nenet e këtij statuti do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodi Civil dhe çfarëdo ligji specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 25: Mosmarreveshjet

Për mosmarreveshjet që mund të lindin me zbatimin apo interpernim e normave të këtij statuti, si edhe për mosmareveshjet që mund të lindin mdis shoqërise dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare

Nënshkrimi dhe firma e ortakeve te shoqërisë:

**Adriano Giaquinto**

Adriano Giaquinto

Gjykatën Ashtim

**Eglantina Behari**

Eglantina Behari

Eggy